

Njoftim për përqendrim me të cilin Akros Media Holding a.s. nga Sllovakia do të fitojë kontroll të pavarur mbi Adriatik Advertajzing d.o.o. nga Serbia, I&F Mediabrands d.o.o. nga Serbia, I&F Akaunting d.o.o. nga Serbia, I&F Lokomotiva d.o.o. nga Serbia dhe Media Pul d.o.o. nga Serbia

(lënda nr. 08-144 /2023)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 29.09. 2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim që i referohet marrjes së kontrollit të pavarur nga Akros Media Holding a.s. me seli në Jlenia 3131/1, Bratislavë, Sllovakia mbi shoqëritë: Adriatik Advertajzing d.o.o., shoqëri me seli në rr. Terazije nr. 7-9 / Stari Grad, Beograd, Serbi, I&F Mediabrands d.o.o., me seli në rr. Terazije nr. 7-9 / Stari Grad, Beograd, Serbi, I&F Akaunting d.o.o. me seli në rr. Terazije nr. 7-9 / Stari Grad, Beograd, I&F Lokomotiva d.o.o., me seli në rr. Terazije nr. 7-9 / Stari Grad, Beograd, Serbi dhe Media Pul me seli në rr. XHorxha Vajferta nr. 78, Beograd, Serbi, përmes shitblerjes së pjesëve.

- **Akros Media** është pjesë e Grupit Acros, një nga grupet e investimeve më të qëndrueshme dhe me rritje më të shpejtë në rajonin e Evropës Qendrore, aktive në fushat e menaxhimit të mjeteve dhe pasurisë, mikpritjes, pasurive të paluajtshme, kapitalit privat dhe kapitalit sipërmarrës. Grupi Akros ka selinë në Bratislavë, Sllovakia dhe është aktive në treg që nga viti 2002. Grupi Akros nuk është aktiv në Maqedoninë e Veriut.
- **Adriatik Advertajzing d.o.o.** është një kompani e menaxhimit që ofron shërbime të funksionit mbështetës vetëm për shoqëritë e varura të saj. Adriatik Advertajzing d.o.o. është aktive në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërive të varura të saj në pronësi të plotë:
- **Agjencia e Komunikimeve dhe Shërbimeve të Marketingut MekKen SHPKNJP Shkup** me numër regjistrimi 5185785, me seli në Bulevardin 8 -Shtatori nr. 16, Shkup dhe me aktivitet të regjistruar prioritar-agjenci për marketing dhe
- **Agjencia e Komunikimeve dhe Shërbimeve të Marketingut Ad+Venture SHPKNJP Shkup** me numër regjistrimi 7251912, me seli në bulevardin Partizanski odredi nr. 26A-1/2 dhe me aktivitet prioritar të regjistruar – agjenci marketingu.
- **I&F Mediabrands d.o.o.** është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Serbisë, një kompani e menxhamit që ofron shërbime për një funksion mbështetës vetëm për shoqëritë e varura të saj. I&F Mediabrands është aktive në Maqedonia e veriut përmes shoqërive të varura të saj - **Kompania për komunikim dhe shërbime marketingu Universal Media SHPKNJP Shkup**, me seli në bulevardin 8 shtator nr. 16, Shkup dhe aktiviteti prioritar i regjistruar-agjenci për marketing.
- **I&F Akaunting d.o.o.** është një kompani e themeluar në përputhje me ligjet e Serbisë, duke ofruar shërbime të kontabilitetit, pagave dhe njoftimeve tatimore. I&FAkaunting nuk është aktiv në Maqedoninë e Veriut.
- **I&F Lokomotiva d.o.o.** është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Serbisë. I&F Lokomotiva d.o.o. e specializuar në zhvillimin e zgjidhjeve komplekse softuerike për kompanitë dhe shërbime profesionale për krijimin e vlerës, si dhe zgjidhjet për tregti elektronike. I&F Lokomotiva nuk është aktive në Maqedoninë e Veriut.
- **Media Pul d.o.o.** është një shoqëri e themeluar sipas ligjeve të Serbisë dhe është një kompani blerëse e hapësirës mediatike që blen hapësirë mediatike nga lloje të ndryshme të mediave (TV, mediat e shkruar, internet dhe të tjera) dhe ua shet atë hapësirë mediatike klientëve të saj. Media Pul nuk është aktive në Maqedoninë e Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë te Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

04.10.2023

Shkup